



STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 10 dhjetor 2012

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON ZGJATJEN E AFATIT PERFUNDIMTAR PER NDIHMEN E KATASTROFES NGA FEMA

Banorët e trembëdhjetë qarqeve të shpallura mund të kërkojnë ndihmë të katastrofës nga FEMA deri më 28 janar 2013

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot se afati përfundimtar për banorët që jetojnë në një nga trembëdhjetë qarqet e shpallura në katastrofë për t'u rregjistruar për ndihmë nga FEMA është zgjatur deri më 28 janar 2013. Afati përfundimtar i mëparshëm ishte 31 dhjetor 2012.

Ndihma federale e katastrofës për individët dhe familjet mund të përfshijë para për ndihmë me qiranë, riparime thelbësore të shtëpisë, nevoja të pronës personale të humbur dhe nevoja të tjera të rëndësishme që kanë lidhje me katastrofën jo të mbuluara nga sigurimi. Banorët në qarqet e mëposhtme kualifikohen për ndihmë: Bronks (Bronx), Kings (Kings), Naso (Nassau), Nju Jork (New York), Riçmond (Richmond), Roklënd (Rockland), Uestçester (Westchester), Suffolk (Suffolk), Kuins (Queens), Oranxh (Orange), Putnëm (Putnam), Sallivën (Sullivan) dhe Ulstër (Ulster).

“Ndërsa punojmë për të ndihmuar që komunitetet të rimëkëmben, kjo zgjatje do të jetë një ndihmë e madhe për banorët e Nju Jorkut (New Yorkers) që u goditën rëndë nga Uragani Sendi (Sandy),” tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). “Ndërsa hyjmë në sezonin e festave dhe fillojmë Vitin e Ri, kjo zgjatje do t'u lejojë familjeve dhe individëve të prekur kohë shtesë për të bërë kërkesë për asistencën mjaft të nevojshme për të ndihmuar në rindërtimin dhe rimëkëmbjen.”

Individët mund të rregjistrohen në internet në www.disasterassistance.gov ose nëpërmjet telefonave inteligjentë ose kompjuterëve portative në m.fema.gov.

Aplikuesit mund të telefonojnë gjithashtu në 800-621-3362 ose (TTY) 800-462-7585. Aplikuesit që përdorin 7-1-1 Shërbimet me Rele ose Shërbimet me Rele Video (Video Relay Services) (VRS) mund të telefonojnë në 800-621-3362. Numrat telefonikë falas funksionojnë 24 orë në ditë, shtatë ditë në javë, deri në një njoftim të mëtejshëm.

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov

Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418

Albanian